

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

NË MES TË:

DOA PHARMACY CENTER Sh.P.K

DHE

SINDIKATËS SË POLICISË SË KOSOVËS - DEGA NË MITROVICË

PËR:

**SHITJEN ESENCIALE TË PRODUKTEVE MEDICINALE DHE
FARMACEUTIKE ME PAKICË, ME ZBRITJE PREJ 10% PËR
SECILIN PJESTARË TË POLICISË SË KOSOVËS TË CILËT JANË
ANËTARË TË SINDIKATËS SË POLICISË SË KOSOVËS NGA
REGJIONI I MITROVICËS**

Vushtrri, qershor 2022

Neni 1 Qëllimi

1. Ky Memorandum i Mirëkuptimit (*më tej: MIM*) ka për qëllim:
2. Ofrimin dhe shitjen e çdo produkti medicinal dhe farmaceutik me pakicë që është esencial për shëndetin e çdo pjesëtari të Policisë së Kosovës që është anëtar i Sindikatës së Policisë së Kosovës në regjionin e Mitrovicës, duke përfshirë të pjesëtarët/anëtarët nga të gjitha njësitet policore.

Neni 2 Palët nënshkruese

Palët nënshkruese të këtij MIM janë:

1. Besnik Basholli, Drejtor Menagjues i Doa Pharmacy Center Sh.P.K me seli në Vushtrri; dhe
2. Avni Tahiri, Kryetar i Sindikatës së Policisë së Kosovës – dega në Mitrovicë.

Neni 3 Pajtimi i vullnetit

Palët nënshkruese të këtij MIM pajtohen që me vullnetin e tyre të plotë të bëjnë ndarjen e përgjegjësive që do të jenë objekt i këtij MIM sipas nenit 4 të këtij MIM.

Neni 4 Obligimet dhe përgjegjësitë e palëve nënshkruese

1. DOA Pharmacy Center Sh.P.K me seli në Vushtrri me të gjitha njësitë e saj, do të ofrojë produkte medicinale dhe farmaceutike me pakicë për nevoja esenciale dhe që konsiderohen të domosdoshme për ruajtjen e shëndetit të çdo pjesëtari/anëtari të Sindikatës së Policisë së Kosovës, dega në Mitrovicë, me çmim prej **10% (dhjetë përqind) zbritje** në secilin produkt medicinal dhe farmaceutik, përjashtimisht produkteve të qumshtit për fëmijë.
2. Pjesëtarët e Policisë së Kosovës, përkatësisht pjestarët e Policisë së Kosovës që janë edhe anëtarë të Sindikatës së Policisë së Kosovës, dega në Mitrovicë, për marrjen e shërbimeve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, obligohen që të prezantojnë kartelën

identifikuese me të cilën dëshmojnë se janë pjesëtarë/ anëtarë të Sindikatës së Policisë së Kosovës, dega në Mitrovicë.

3. Doa Pharmacy Center Sh.P.K do të kujdeset që brenda një afati optimal, pjesëtarët/ anëtarët sipas paragrafit 2 të këtij neni, ti pajisë me kartela identifikuese për marrjen e shërbimeve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 5 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët nënshkruese të MIM marrin përsipër të zgjedhin të gjitha çështjet mbi kontaktin dhe zbatimin e këtij MIM, me konsultime dhe negociata bilaterale dhe të drejtpërdrejta.

Neni 6 Ekzemplarët

Ky MIM është i punuar në Gjuhën Shqipe dhe në 2 (dy) ekzemplarë, ku pas nënshkrimit të të njëjtit, secilës palë i mbetet nga 1 (një) ekzemplarë.

Neni 7 Hyrja në fuqi

Ky MIM do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të palëve nënshkruese dhe rrjedhimisht obligon palët nënshkruese për fillimin e zbatimit të tij deri në një afat të pacaktuar, përkatësisht deri në shkëputjen e tij ose marrjen e ndonjë vendimi tjetër përkitazi me këtë çështje.

PALËT NËNSHKRUESE:

Subjekti farmaceutik:
Doa Pharmacy Center Sh.P.K
Vushtrri

Besnik BASHOLLI
Drejtor Menagjues

DOA PHARMACY
CENTER

Institucioni:

Sindikata e Policisë së Kosovës
Dega në Mitrovicë

Avni TAHIRI
Kryetar

v.v

Vushtrri, 02/05/2022.

